

VENDIM
Nr. 708, datë 26.8.2015

**PËR LLOJET, PERIODICITETIN DHE MËNYRËN E RAPORTIMIT TË TË
DHËNAVE STATISTIKORE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR NGA STRUKTURAT
SHTETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas fushave ku operojnë, me qëllim hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave në mbështetje të programeve të aksesit dhe të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.

2. Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave nga institucionet, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave, për garantimin e konfidencialitetit dhe për respektimin e jetës private të tyre. Këto të dhëna janë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

3. Institucionet e pavarura, bazuar në funksionimin e tyre, i dërgojnë, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, krijuar pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar.

4. Institucionet e administratës shtetërore, bazuar në funksionimin e tyre, i dërgojnë, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Bashkitë u dërgojnë, periodikisht, nëpunësve që mbulojnë çështjet e aftësisë së kufizuar, në qarkun përkatës, të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Qarku përpunon të dhënat statistikore për aftësinë e kufizuar, të përcjella nga bashkitë, pjesë e tij, dhe ia përcjell ato, periodikisht, sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

7. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, përpunon të dhënat e grumbulluara, nëpërmjet sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

8. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, monitoron përditësimin progresiv të të dhënave, sipas treguesve të përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit. Të dhënat janë pjesë e raportit që sekretariati teknik dërgon te të gjithë anëtarët e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.

9. Sekretariati teknik për aftësinë e kufizuar i dërgon të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara, sipas pikave 3–8, të këtij vendimi, në Institutin e Statistikave (INSTAT).

10. Instituti i Statistikave bën anketime të dedikuara për çështjet e aftësisë së kufizuar. Rezultatet e anketimeve i bën publike dhe informon, zyrtarisht, ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

11. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1
TREGUESIT PËR AFTËSINË E KUFIZUAR SIPAS FUSHAVE

Nr.	Lloji i statistikave	Institucioni përgjegjës	Periodiciteti
I	Edukimi		
1	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin parashkollor. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nevojës për mbështetje (nëse duan asistent shtesë).	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
2	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin e detyruar. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nevojës për mbështetje (nëse duan asistent shtesë).	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
3	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin e mesëm. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - tipit të shkollës (e përgjithshme/profesionale/të veçanta).	Ministria e Arsimit Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
4	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë arsimin e lartë. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nivelit (bachelor/master).	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2 herë në vitin shkollor nëntor–maj
5	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë ndërprerë shkollën. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - shkakut të ndërprerjes.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
6	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që përfundojnë shkollën fillore. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë;	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore

	- vendbanimit (urbane/rurale).		
7	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që përfundojnë 9-vjeçaren. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
8	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që përfundojnë shkollën e mesme. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - tipit të shkollës (e përgjithshme/profesionale/të veçanta).	Ministria e Arsimit Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	vjetore
9	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara të diplomuar. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - nivelit (bachelor/master).	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore
10	Numri i mësuesve që kanë marrë kualifikime për aftësinë e kufizuar: - numër fizik; - përqindje/kundrejt totalit.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
11	Numri i shkollave që kanë psikologë: - kohë të plotë; - kohë të pjesshme.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
12	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që shoqërohen nga prindërit gjatë kohës së mësimi	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vjetore
13	Numri i shkollave 9-vjeçare/të mesme/profesionale të aksesueshme për: - fëmijë në karrige me rrota; - fëmijë të verbër.	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore
14	Numri i nxënësve që nuk dëgjojnë që frekuentojnë shkollën e mesme - të përgjithshme; - profesionale; - sipas gjinisë.	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
15	Numri i aktiviteteve sportive ku përfshihen PAK	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore
16	Numri i institucioneve sportive të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Arsimit dhe Sportit Bashkia	Vjetore
II	Shëndetësia		
17	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të	Ministria e	Vjetore

	konstatuar në lindje. Të ndarë sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Shëndetësisë	
18	Numri i fëmijëve autikë të diagnostikuar nga institucionet shëndetësore. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Shëndetësisë	Vjetore
19	Numri i fëmijëve autikë që marrin trajtim në institucione të specializuara. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Shëndetësisë Bashkia	Vjetore
20	Numri i personave me aftësi të kufizuara mendore që marrin trajtim në institucione shëndetësore. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Shëndetësisë	Vjetore
21	Numri i qendrave shëndetësore parësore të aksesueshme (urbane/rurale)	Ministria e Shëndetësisë Bashkia	Vjetore
22	Numri i spitaleve të aksesueshme	Ministria e Shëndetësisë Bashkia	Vjetore
III	Drejtësia		
23	Numri i PAK-ut që përfitojnë nga ndihma ligjore falas. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Drejtësisë	Vjetore
24	Numri i PAK që aplikojnë për të përfituar nga ndihma ligjore falas. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale).	Ministria e Drejtësisë	Vjetore
25	Numri i institucioneve të drejtësisë të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Drejtësisë	Vjetore
26	Numri i proceseve gjyqësore ku janë të përfshirë PAK. Të ndarë sipas: - paditës;	Ministria e Drejtësisë	Vjetore

	- i paditur.		
IV	Strehimi/zhvillimi urban/infrastruktura/transporti		
27	Numri i banesave të aksesueshme, të ndërtuara nga EKB-ja	Ministria e Zhvillimit Urban Enti Kombëtar i Banesave	Vjetore
28	Numri i aplikimeve të bëra nga PAK-u për procedurë legalizimi	ALUIZNI	Vjetore
29	Numri i PAK-ut, përfitues nga ligji për legalizimin	ALUIZNI	Vjetore
30	Numri i stacioneve dhe i mjeteve të transportit qytetës të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Bashkia	Vjetore
V	Punësimi		
31	Numri i PAK-ut të regjistruar si punëkërkues të papunë pranë zyrave të punësimit	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
32	Numri PAK-ut të punësuar nga zyrat e punësimit	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
33	Numri i PAK-ut të punësuar në subjekte private, ndarë sipas gjinisë	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
34	Numri i PAK-ut të punësuar nga programi specifik për nxitjen e punësimit të PAK-ut, ndarë sipas gjinisë	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	6-mujore
35	Fondi i shpenzuar për punësimin e PAK-ut, nga programi specifik për nxitjen e punësimit	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
36	Numri i zyrave të punësimit të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
37	Numri i qendrave të arsimit profesional të aksesueshme për PAK-un	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
38	Numri i PAK-ut që ndjekin kurse profesionale. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë; - vendbanimit (urbane/rurale); - llojit të kursit profesional.	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
39	Numri i PAK-ut që punësohen pas përfundimit të kurseve profesionale	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Vjetore
VI	Kultura		
40	Numri i institucioneve dhe i objekteve të	Ministria e	Vjetore

	kulturës të aksesueshme për PAK-un	Kulturës Bashkia	
41	Numri aktiviteteve kulturore ku janë të përfshirë PAK	Ministria e Kulturës Bashkia	Vjetore
42	Numri i artistëve me aftësi të kufizuara. Të ndarë sipas: - grup-moshës; - gjinisë.	Ministria e Kulturës Bashkia	Vjetore